

STATUTI I SHOQËRISË DHE AKT THEMELIMI “YLLIRI FILMS” SH.P.K

KREU I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia

Neni 1: Data e themelimit, Emri dhe Themeluesi

Sot me datë 07.09.2018 unë themeluesi Astrit Hykaj, i biri Hysni Hykaj, i datëlindjes 1968 në bazë të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 03.05.2007 dhe të ligjit 9901 datë 14.04.2008 regjistroj pranë QKR shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar me emrin: “**YLLIRI FILMS**” sh.p.k.

Themeluesi i shoqërisë është **Ortaku i Vetëm** z. Astrit Hykaj
Ortaku i Vetëm vendosi që shoqërinë ta emërtojë: “**YLLIRI FILMS**” sh.p.k.

Neni 2: Objekti

1. Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm: Filma artistik të gjatë dhe të shkurtër, prodhim dokumentari.
2. Shoqëria kryen cdo lloj veprimtarie të dobishme për arritjen e saj duke përfshirë edhe veprime për shitblerje pasurish te luajtshme dhe të paluajtshme si dhe nëse e sheh të arsyeshme të marrë pjesë me kuota dhe aksione në shoqëri të tjera.

Neni 3: Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë e pacaktuar.

Neni 4: Selia, Adresa elektronike

Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: “Shpia e Çunit”. Nr.1. Rr. Hiqmet Buzi, Njësia Bashkiake Nr 2, Tiranë. Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon: shekulliiri@yahoo.com

KREU II

Kapitali i Registruar

Neni 5: Vlera dhe pagesat e kapitalit të registruar.

Kapitali themeltar fillestare i shoqërisë është 1.000 lekë e përbërë nga një kuotë me vlerë nominale 1.000 lekë.

Neni 6: Administratori në lidhje me kuotat

Kuota e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar zotërohen nga ortaku i vetëm Astrit Hykaj të cilit i përkasin të gjitha kuotat edhe si administrator , edhe në momentet që ai shkarkohet nga funksioni si administrator dhe emëron dikë tjeter në atë vend. Administratori tjeter i emëruar nuk i përket asnjë kuotë nga ato që ka shoqëria, derisa nuk është ndryshuar në status.

Neni 7: Administrator dhe Kompetencat.

Administratori i shoqërisë “**YLLIRI FILMS**” sh.p.k. është z. Astrit Hykaj. Politika tregtare e shoqërisë do të administrohen nga administrator i cili mund të ushtrojë të gjitha kompetencat. Aktet e dala nga administratori i mëparshëm nuk shfuqizohen nga administratori në fuqi. Administratori, nëse nuk është ortaku i vetëm por i emëruar prej tij gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për cdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare.

Kompetencat janë:

1- ka të drejtë dhe detyrë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimit tregëtar të shoqërisë.

2- të përfaqësoj shoqërinë tregtare

3- të kujdeset për mbajtjen saktë e të rregullt të dokumentave dhe të librave kontabël të shoqërisë.

4- të përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor

5- të ushtrojnë kompetencat që i njihen në ligj ose në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita.

6- të vlerësojnë me përgjegjësi ceshtjet, për të cilat merret vendim

7- të parandalojnë dhe mënjanojnë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personal me ato të shoqërisë.

8 – Qëndrimi i administratorit në detyrë sipas ligjit në fuqi është 5 vjet.

Neni 8: Detyrimi i besnikërisë dhe përgjegjësia

Administratori duhet të kryej detyrat e tij të përcaktuara në ligj ose në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të vecantë ndikimit të veprimitarisë së shoqërisë në mjedis.



Neni 9: Mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave

1. Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalinë e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit
- d) cdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj

Neni 10: Vendimet e shoqërisë

Meqënëse shoqëria zotërohet nga një ortak vendimet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet ushtrohen nga ortaku i vetëm. Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm registrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënët e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen.

Duhen regjistruar në vecanti, por pa u kufizuar në to , vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërdarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Neni 11: Skualifikimi dhe Shkarkimi i Administratorit

Detyra e administratorit nëse është i emëruar nga ortaku përfundon në rast se:

- 1- personi nuk është më Administrator sipas parashikimeve të Ligjit përfshirë edhe parashikimet e pikës 6 të nenit 95 të Ligjit;
- 2- personi vuani apo mund të vuaj nga crregullime mendore;
- 3- personi jep dorëheqjen nga detyra duke njoftuar shoqërinë.

Neni 12: Shpërblimi, Përfitimet e tjera dhe Shpenzimet e Administratorit

- a) Shpërblimi, sipas pikës 1 të këtij neni, duhet të jetë i përshtatshëm dhe në përpjekje me detyrat e administratorit dhe gjendjen financiare të shoqërisë.
- b- Nëse shoqëria është në vështirësi financiare, Ortaku i vetëm mund të vendos reduktimin e shpërblimit të administratorit në masën e përshtatshme.
- c- Administratorit mund ti paguhen të gjitha shpenzimet e udhëtimit, akomodimit dhe shpenzime të tjera në lidhje me përbushjen e detyrave të tij.



Neni 13 Njoftimi i dorëheqjes dhe heqja e të drejtave për administrit

Në rast se administrator është i emëruar nga ortaku, mund të japë dorëheqjen nga detyrat e tij, për shkaqe të arsyeshme , duke bërë njoftim paraprak, në një kohë të përshtatshme , për të mundësuar vazhdimin e veprimeve nga vete ortaku ose administrator tjetër, me përashtim të rasteve kur dorëheqja e menjëherëshme vlerësohet e justifikuar për një arsyet e rëndësishme.

Neni 14 Humbja dhe fitimi

1. Në fund të cdo viti finansiar administrator përgatit pasqyrat vjetore financiare, ku përcaktohen fitimi dhe humbja.

Neni 15: Njoftimet

1- Njoftimet e kryera nga ortaku për administratorin dhe anasjelltas sipas parashikimeve të Statutit duhet të jenë me shkrim ose nëpërmjet komunikimit elektronik në adresën e këtij Statuti dhe janë të vlefshme në lidhje me kohën e njoftuar për këtë qëllim dhe personin që kryen njoftimi.

Neni 16: Prishja dhe Likujdimi

1- Shkaqet e prishjes së shoqërisë

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar prishet:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelin e saj;
- b) me vendim të Ortakut të Vetëm të Shoqërisë.
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- d) me vendim të gjykatës;
- dh) për arsyet e tjera, të parashikuara në statut .

2- Në rast të likujdimit të shoqërisë, likujduesi në përputhje me Ligjin dhe me vendimin e marrë nga administrator mund të shpërdajë në dobi të ortakut të gjithë vlerën e pasurive të shoqërisë.

Ortaku i vetem themelues
Astrit Hykaj

